

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ndryshime në qeveri, LARGOHET një tjetër ministër i Edi Ramës
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/lajm-i-fundit-ndryshime-ne-qeveri-largohet-nje-tjeter-minister-i-ed-i-i400943
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 08:05:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 08:01:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	62fc613dc20b16589fc90f93eafd6deded0d22b33d443e1a4b35a622fbe7a17f
TEKSTI	60782bb228ee7901175b9367349a635959ab1026df9a9208d7460415019ee19a
PAMJA	7c40bdefbfe7eb1904cd2ba3691d429135807bd10217216aa96abedcd8eafd58

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5c4a5f47f03799c901e023e4e791d3a6140eda30f870812237118b86902c799a
E MËPARSHMJA	1aff700e9f3b063357cf077183fcf04acf4bc092fc224df48cc9778fe91fe037
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5c4a5f47f03799c901e023e4e791d3a6140eda30f870812237118b86902c799a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



12 numrat e parë FALAS!

[Version PDF](#)

[Abonohu te Revista](#)



- [Kreu](#)
- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)
- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)



Created and monetized by  mediadesk



Çështjet kryesore

Live Updates

[Arrestohet Ergys Agasi](#)

E Enjte 10:25

Live Updates

["Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!](#)

E Hënë 09:32

Live Updates

[SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjijkës](#)

E Martë 14:24

[Aktualitet](#) 11 Shtator 2026, 10:01

Ndryshime në qeveri, LARGOHET një tjetër ministër i Edi Ramës

Shkruar nga Newsbomb



 Ndryshime në qeveri, LARGOHET një tjetër ministër i Edi Besfort Lamallari

Pas dorëheqjes të ish-ministres tanimë të Shëndetësisë, Evis Salës, një tjetër ministër është larguar nga kabineti Rama. Bëhet fjalë për Besfort Lamallarin, dibranin të cilin një vit më parë Edi Rama e surprizoi duke e emëruar fillimisht si ministër të Drejtësisë, e më pas të Brendshëm.

Burime për mediat bëjnë me dije se fundmi kryeministri Rama ka vendosur të shkakrojë Lamallarin nga posti i minsitrit të Brendshëm. Një vit më parë ai u emërua në krye të Ministrisë së Drejtësisë, për të kaluar pas disa muajsh më pas në drejtimin e Ministrisë së Brendshme.

Por kush është Besfort Lamallari?

I lindur më 18 korrik 1987 në Peshkopi të Dibrës, Lamallari është një nga emrat me një profil të gjatë në fushën e drejtësisë, sigurisë dhe luftës kundër krimit të organizuar.

Ai ka përfunduar studimet universitare për Drejtësi në Universitetin e Tiranës në vitin 2009. Më pas, vijoi studimet pasuniversitare në Itali, ku u diplomua me një LL.M në "Bashkëpunim Ndërkombëtar kundër Krimit të Organizuar Transnacional".

Në vitin 2013, Lamallari u diplomua në Universitetin e Oksfordit me një Master Shkencash në Kriminologji dhe Drejtësi Penale.

Karriera e tij profesionale është e lidhur ngushtë me çështjet e sigurisë, krimit të organizuar, radikalizimit dhe terrorizmit. Ai ka shërbyer si studiues dhe konsulent për organizata të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë Këshillin e Evropës, OSBE-në dhe Bashkimin Evropian.

Në tetor të vitit 2017, Lamallari mori detyrën e Zëvendësministrit të Brendshëm, ndërsa më herët kishte shërbyer edhe si Këshilltar i Ministrit të Brendshëm.

Që prej vitit 2020, ai ka përfaqësuar Shqipërinë si negociator përgjegjës për Kapitullin 24, "Drejtësia, Liria dhe Siguria", në kuadër të negociatave me Bashkimin Evropian.

Gjatë karrierës së tij, Lamallari ka përfaqësuar gjithashtu Shqipërinë në bashkëpunime me institucione dhe organizata ndërkombëtare si UNODC, Europol dhe FRONTEX.

Ai ka qenë pjesë edhe e angazhimeve shtetërore në situata emergjente. Në nëntor të vitit 2019 dhe prill të vitit 2020, shërbeu si delegat i Qeverisë dhe i Komitetit Ndërmintoror për Emergjencat Civile, përkatesisht në menaxhimin e ekipeve të kërkim-shpëtimit pas tërmetit në Durrës dhe në adresimin e situatës së krijuar nga epidemia e Covid-19 në rajonin e Shkodrës.

Profilin e tij akademik plotësohet nga një përvojë e gjerë në kërkimin shkencor. Lamallari ka qenë studiues i pavarur dhe autor i disa studimeve që lidhen me krimin e organizuar, radikalizimin dhe terrorizmin.

Përpara se të merrte drejtimin e Ministrisë së Brendshme, ai u emërua Ministër i Drejtësisë në shtator të vitit 2025, ndërsa në mars të vitit 2026 kaloi në krye të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

-

[LAJM I FUNDIT/ Edi Rama merr me vete në Kryeministri Besfort Lamallarin: Faleminderit për shërbimin si ministër i Brendshëm](#)

11 Shtator, 10:26



[Edi Rama shkarkoi Besfort Lamallarin, vendos t'ia besojë ministrinë e Brendshme Ervin Demos](#)

11 Shtator, 10:11

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu

Aktualitet

[Në kërkim nga Italia për tentativë vrasje, plagosje e shkatërrim prone, ARRESTOHET në Ndroq 33-vjeçari \(VIDEO\)](#)

E Premte 10:11

Aktualitet

["Nuk vonohem se kam një surprizë!" Tetë vite asnjë gjurmë e tij, Gjykata e Vlorës shpall zyrtarisht të zhdukur Elvis Troqen](#)

E Premte 09:50

Aktualitet

[Të rinjtë ikin, por dhe ata që mbeten nuk kanë ku punojnë, papunësia e tyre rritet 16%](#)

E Premte 08:12

Aktualitet

[Fillojnë shirat, zonat ku do të ketë reshje shiu sot, si do të jenë temperaturat](#)

E Premte 07:10

Aktualitet

[Thaçi flet për Edi Ramën: Hallall që nuk po dorëzohet përballë vështirësive, Shqipëria po ecën përpara](#)

E Enjte 23:35

Aktualitet

["Nëse ka 1% faj, të shkojë në burg", vëllai i Igli Tares sqaron akuzën e SPAK: Vilat janë blerë direkt nga ndërtuesi në 2020, kurse tenderi është bërë në 2021! Është turp](#)

E Enjte 23:22

Aktualitet

[Merr fund arratia e Adrian Gjebeshit alias Merlika, kapet me armë dhe 20 mijë euro në hotelin e tij në Fushë-Krujë](#)

E Enjte 22:49

Aktualitet

[Kinezët refuzojnë t'i paguajnë, banorët e Marinzës ngujohen në zyrat e "Bankers Petroleum": Duam zgjidhje për qiratë e tokave](#)

E Enjte 22:50

Aktualitet

[Tmerr në Korfuz, shqiptari 51-vjeçar akuzohet se abuzoi me mbesën 8-vjeçare](#)

E Enjte 22:31

Aktualitet

[Negociatat e Ron Yefet me ukrainasit për armë, Ardi Veliu mohon përfshirjen: Se çfarë bën ai në jetën private, është përgjegjësi e tij! KAYO nuk ka mundësi për prodhim](#)

E Enjte 22:04

Aktualitet

[Përgjimet e Ron Yefet me ukrainasit për armë, partnerja shqiptare e TIMAK: Ai na ka premtuar se do investojë 70 milionë euro, dhe ka nisur! Në fundvit, kalojmë miliarda](#)

E Enjte 21:33

Aktualitet

[Pagat e magjistratëve, Deputetja e PS Aulona Bylykbashi: Moskalimi nuk vjen nga bllokimi i Ministrisë së Financave, por nga një formulë që nuk bazohet në ligj](#)

E Enjte 21:28

Aktualitet

[30 vatra zjarri në 24 orë në vend, 7 ende aktive, Ministria e Mbrojtjes: Në terren 404 forca dhe mbi 20 automjete zjarrfikëse](#)

E Enjte 21:11

Aktualitet

[Ngërçi për bllokimin e pagave, Manjani: Magjistratët po shkelin ligjin! Rrogat s'i vendosin KLGJ dhe KLP, por Parlamenti](#)

E Enjte 21:04

Aktualitet

[Ushtarakët shqiptarë stërviten në Kosovë me kolegët britanikë, për garën ndërkombëtare “Cambrian Patrol”](#)

E Enjte 20:48

Aktualitet

[Migjistratët e çuan në SPAK për pagat, reagon Ministri i Financave: Të kallëzohesh sepse po zbaton ligjin! Ja sa shkon fatura](#)

E Enjte 20:44

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit

Politikë

[U vendos në krye të Ministrisë së Brendshme, Ervin Demo falenderon Ramën për besimin: Do vazhdoj të çoj përpara punën e nisur nga Besforti](#)

E Premte 10:33

Politikë

[Edi Rama merr me vete në Kryeministri Besfort Lamallarin: Faleminderit për shërbimin si ministër i Brendshëm](#)

E Premte 10:25

[Zbulohet më shumë artikuj >](#)

Hapësire reklamuese

bombvideo

[Shiko video të tjera në Newsbomb Youtube](#)



[Blutë e Vlorës prangosin dy “skifterët” që vodhën 3 makina, 40 vjeçari grabiti Benz-in deri...](#)



[Më i lumtur se kurrë, Berisha merr pjesë në Konventën e Republikanëve të Trump](#)



[18 vjeçari "nuk zë mend", Policia i tregon vendin: Ishte në arrest shtëpie për vjedhje, doli dhe...](#)



["Të ecim me tjetër ritëm", Taulant Balla kërkon bashkëpunim me opozitën për Shqipërinë në BE](#)



[Intervista e Arben Ahmetajt, Bardhi thumbon keq socialistët: Ia jepni vetë informacionet](#)



[Aksident në autostradën Levan-Tepelenë, makinat përplasen "kokë më kokë"](#)

**op
ed**

OpEd

[Ramë Pagëzimori, Rilindishtja dhe arti i qeverisjes me fjalor](#)

E Diel 16:23 Adri Nurellari

OpEd

[Një moment vendimtar për Shqipërinë](#)

E Martë 13:45

OpEd

[Një dritare mundësie për Tiranën: Pse “Jo”-ja e Islandës ndaj BE-së favorizon integrimin e Shqipërisë](#)

E Diel 18:33



-
-
-

Newsbomb është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

Drejtor i Përgjithshëm: Retin Toka
NIPT: L42417011Q

[Abonohu te Revista](#)

Created and monetized by  mediadesk

- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)

- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Teknologji](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)

Merr lajme me email

- [Kontakt](#)
- [Të drejtat e përdorimit](#)
- [Cookies](#)

Created and monetized by  mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.